




**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN**



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
VU644-24-7673-2-1-1/C913  
14 Nr. 622/24  
Dt. 02.09.2024

**KONTRATË SHËRBIMI**  
**( Kontratë Kornizë )**

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Ilmi Azemi - Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **POROSITËSI**), dhe
2. **" Abdurrahman Fazliu B.I. "emri i biznesit " K.T. Avdyrrahman Fazliu "emri tregtar, me seli në fsh. Kollë/K. Vushtrri, si operatorë ekonomik, me ARBK: 810693160, të cilën e përfaqëson z. Abdurrahman Fazliu, në tekstin e mëtejshëm **KRYESI I SHËRBIMIT****

**Lënda e kontratës: Llot 8 - Transporti i nxënësve në relacionin: nga fsh. fshatrat Kollë dhe Bruznik, lagjet Ilaz Kolla, Mehmeti, Muzaqi, Shaqiri, në SHFMU „Emin Duraku“ në Novolan dhe anasjelltas**  
**{ 71 nxënës x 93,29€ për ditë pune }**  
**{ 39 nxënës ndërrimi i para ditës dhe 32 nxënës ndërrimi i pas ditës }**

**Neni 1.**

- 1.1. Porositësi me rastin e përpilimit të kësaj kontrate i ofron punë Shërbyesit që ky i fundit të ofroj shërbime të transportit të nxënësve të cilat duhen të jenë në harmoni të plotë me kushtet dhe kriteret teknike të specifikuar si në dokumentacionin standard të Dosjes së tenderit me nr. të ref. VU644 - 24 - 059 - 211
- 1.2. Transporti i nxënësve në relacionin shtëpi - shkollë - shtëpi, si në titullin e lëndës të kësaj kontrate, do të bëhet nga data: **02.09.2024** dhe do të zgjasë deri më datë **30.06.2025**, për muajt: Shtator, Tetor, Nëntor, Dhjetor 2024 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj dhe Qershor 2025 në ditët që sipas Plan Programit mësimor zhvillohet procesi mësimor, respektivisht deri më datën të cilën e saktëson Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

**Neni 2.**

- 2.1. Çmimi i kontratës është për njësi, ditë pune/shërbimi brenda një muaji kalendarik, dhe ka vlerën prej **93,29€/ditë pune**, që paraqet çmimin e një ditë pune, të cilën Autoritetit Kontraktues duhet t'ia paguaj Kryesit të Shërbimeve në bazë të Raportit mbi konfirmimin e ekzekutimit të shërbimeve mujore të hartuar nga Menaxheri i kontratës i A.K.. Vlera e përgjithshme e kontrates për 10 muaj është **17,258.65 €**.
- 2.2. **Siguria e ekzekutimit të kontrates do të bëhet me vlerë 10% të vlerës përgjithshme të kontrates me afat të validitetit për periudhën 02.09.2024 deri 30.07.2025**

**Neni 3.**

- 3.1. Kryesi i Shërbimeve merr për obligim që realizimi i kësaj kontrate të zbatohet në përpikëri, duke përdorur pajisjet teknike të dëshmuara në dosjen e tenderit gjatë procesit të aplikimit. Mjetet e transportit duhen të jenë gjithëherë në gjendje teknike të rregullt dhe të drejtohen nga personi i kualifikuar.
- 3.2. Po ashtu Kryesi i Shërbimeve siguron Autoritetin Kontraktues se, duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me transport të veçantë të udhëtarëve dhe në bazë të lejes së veçantë, në këtë rast të nxënësve, Kryesi i Shërbimeve, gjatë transportit të nxënësve do të

përfshijtoj udhëtarët tjerë për transport në relacionin e kontraktuar si dhe do të siguroi aq ulëse në proporcion me numrin e nxënësve që transportohen.

- 3.3. Gjithashtu, Kryesi i Shërbimeve, siguron Autoritetin Kontraktues se do të përbushë me përpikëri obligimin e tij që nxënësit me kohë, si në ndërrimin e para ditës ashtu edhe në ndërrimin e pas ditës, t'i marrë në vendin e caktuar nga Njësia e Kërkesës, t'i dërgoi me kohë në shkollë dhe pas përfundimit të orarit të mësimin në të njëjtën mënyrë ti marrë nga shkolla dhe ti dërgoi në vendin e caktuar, duke u kujdesur gjithmonë për konformitetin e transportit dhe sigurinë e nxënësve, marrë parasysh moshën e tyre të re.

**Neni 4.**

- 4.1. Në rast se Shërbyesi dështon në përbushjen e detyrimit si në nenin një të kësaj kontrate, Porositësi mbanë të drejtën ta anuloi kontratën pa pasur ndonjë obligim ndaj Shërbyesit ose për secilën ditë në vonesë të Shërbyesit të zbatoi penale mbi baza ditore në masën 0,25% të vlerës së kontratës për shërbime të pa përfunduara, deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës, në çdo ditë të vonesës.

**Neni 5.**

- 5.1. Kryesi i shërbimit do t'i ofroi nxënësit shërbime të mira të transportit që kanë përbajtjen dhe veçorinë e parashikuar me këtë kontratë dhe të kujdeset për të drejtat dhe interesat e nxënësit, në pajtim me praktikën e mirë në këtë sferë.
- 5.2. Kryesi i shërbimit përgjigjet për dëmin që i shkakton nxënësit për shkak të moszbatimit të plotë ose të pjesshëm të detyrimeve që kanë të bëjnë me organizimin e udhëtimit, sigurinë dhe konformitetin e dëshiruar, që kërkohet për realizimin e kontratës.
- 5.3. Kryesi i Shërbimit nuk ka të drejtë, në asnjë rrethanë, t'u besoj personave të tretë kryerjen e shërbimeve të kontraktuara, përveç personave që janë dëshmuar të kualifikuar, me dokumentacion si në Dosjen e Tenderit.

**Neni 6.**

- 6.1. Porositësi do të emëroi Menaxherin e Kontratës me detyrën që t'i ndërmer gjitha masat, procedurat dhe aktivitetet e punës dhe të mbikëqyrjes, të nevojshme – domosdoshme, për të azhuruar, mundësuar dhe siguruar, në bashkëpunim me organet relevante të Njesisë së Kërkesës, që dispozitat e kontratës të përbushen në kohë nga Kryesi i Shërbimeve, dhe që të drejtat e Autoritetit Kontraktues të përcaktuara në kontratë dhe / ose që lidhen me kontratën të ushtrohen sipas nevojës dhe në pajtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, për të mbrojtur interesin e Autoritetit Kontraktues.
- 6.2. Kontraktuesit pajtohen që Porositësi ta paguaj shumën – çmimin si në nenin dy të kontratës, në bazë të faturës, në konto të Shërbyesit, në afatin prej 28 ditësh nga dita e konfirmimit nga Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues se shërbimet janë kryer në cilësi dhe konformë dispozitave ligjore dhe kontraktuese.

**Neni 7.**

- 7.1. Kontraktuesit pajtohen se janë të një mendimi për rregullat e kësaj kontrate, andaj heqin dorë zgjedhja e njëanshme e sajë.

**Neni 8.**

- 8.1. Kontestet eventuale lidhur me dispozitat e kësaj kontrate palët do t'i zgjedhin me marrëveshje, në të kundërtën, kompetent për zgjidhje të kontestit do të jetë gjykata kompetente sipas ligjit, ndërsa për bazë do të merren dispozitat si në dosjen për Kuotim të çmimeve me **nr. ref. VU644 - 24 - 059 - 211**

**Neni 9.**


- 9.1. Kjo kontratë është përpiluar në 4 ( katër) Origjinale nga të cilat 3( tri) Origjinale për Porositësin dhe 1(një) Original për Kryesin e Shërbimit.

**K O N T R A K T U E S I T :**

Për Kryesin e shërbimit,


  
Avdyr Fahman Fazliu

Për Porositësin,

  
Ilmi Azemi



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
14 Nr. 652/24  
Dt. 03.09.2024

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik / Nr.A01, në bashkëpunim dhe të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese dhe Drejtorit të Drejtorisë për Prokurim Publik, më dt. 03.09.2024 merë:

**V E N D I M**

1. Caktohet Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës për përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që përfaqësohet nga: **Transporti i nxënësve në relacionet sipas LOT1 deri LOT 36, me numër të prokurimit: VU644-24-7673-2-1-1 dhe numër të brendshëm të prokurimit VU644-24-059-211**, si vijon :

**z.Selim Abazi**, caktohet menaxher i kontratës.

**z.Alban Tahiraj**, caktohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës,

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Nenin 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës.

**Përgjegjësitë dhe funksionet e Menaxherit të Projektit / Kontratës, janë me sa vijon, të :**

- Menaxhori obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Kontratë;
- Sigurojë se Op. Ek. i përmbushë të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë se Op. Ek. e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë se ka kontrolli adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së Kontratës;
- Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
- Nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
- Dorëzoj raporte mb. progresin ose kompletimin e një kontratë, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zyrtari Kryesor administrativ;
- Në pajtim me nenin 61.7 të rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxheri i kontratës, menaxheri i Kontratës i A. K. duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloj me fazën e menaxhimit të projektit / Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë Menaxheri i projektit/ kontratës brenda afatit optimal/ të arsyeshëm kohorë, jo më gjatë se dy ditë pune, duhet të krijoj një Plan për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin " Fillimi / rimboblizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do të krijet nga Sistemi i prokurimit elektronik në bashkëpunim me Menaxherit të kontratës të A.K. dhe O.E. - Kontraktuesit, duke re-shikuar të dyja palët. Menaxheri i Projektit do ta përcjell një kopje të Planit për menaxhimin e kontratës Departamentit të Prokurimit. Pas Zyrtari përgjegjës i Prokurimit pranon Planin për menaxhim të kontratës , Menaxheri i Projektit do të lëshoi Op. Ek. kontraktuesit i ctron për fillimin e punëve, kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësi të përcaktuara si në Kushtet Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

Përgjegjës dhe funksionet e Mbikëqyrës të Menaxherit të Projektit/ Kontratës, janë me sa vijon :

- mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e implementimit të kontratës;
- administrimi i plotë i kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventualet të kontratës, dhe
- rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit- vlerësim të propozuar nga menaxheri i kontratës nën mbikëqyrjen e tij.

3. Vendimi nyn në fuqi dhe zbatohet ditën e marrjes ndërsa, për bazë do të ketë zbatimin e përpiktë të kontratës mes Autoritetit Kontraktues-Komunës së Vushtrrisë dhe Operatorëve Ekonomik: **Të shpallur në Njoftimin për Dhënie të Kontratës.**

Kopjo: Menaxheri i Kontratës;  
Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës;  
Drejtorise së Prokurimit;  
Drejtorit të Njësisë Kërkuese

Ferit Idrizi



Kryetar i Komunës

## KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni, Nr.	
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë : <b>Ligji në fuqi në Republikën e Kosovës.</b>
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë : <b>gjuha e përdorur nga pala.</b>
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është : <b>10 % e vlerës së përgjithshme të kontratës për kohëzgjatjen e periudhës prej 13 muaj e lëshuar nga një bank ose kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovë.</b>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Shërbimet brenda <b>1 ( një )</b> ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është :

Fillimi i punëve	17.1	konform afatit të përcaktuar në kontratën bazë.  Data e fillimit do të jetë : Kontrata hynë në fuqi me rastin e nënshkrimit të kontratës, dhe shërbimet do të kryhen sipas porosisë nga njësia e kërkesë – Menaxheri i Kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha shërbimeve do të jetë : sipas afatit/kohëzgjatjes, por jo më gjatë se 10 muaj në pikën II.3 të Njoftimit për Kontratë.
Dëmet likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <b>0,10 % të çmimit përfundimtar të Kontratës, për ditë të vonuar nga ana e Kontraktuesit.</b>  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha shërbimet është <b>10 % e Çmimit final të Kontratës.</b>
Regjistri i punës	20.1	Kontraktuesi – Kryesi i Shërbimeve përkatësisht Menaxheri i Projektit i Autoritetit Kontraktues do të mbajnë dhe evidentojnë shërbimet e përfunduara në Planin për Menaxhimin e Kontratës, gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës, për të evidentuar gjitha përshkrimet e shërbimeve të ekzekutuara në terren, për të konfirmuar numrin e ditëve të ekzekutuara, cilësinë e shërbimeve, gjithashtu për të evidentuar ecurinë e shërbimeve, pengesat eventuale, aktivitetet e ndërmarra për eliminimin e pengesave të shfaqura, kohëzgjatjen e kohës sa kanë zgjatur pengesat dhe në fund, pas përfundimit të shërbimeve, për të dhënë në baza mujore një Raport me shkrim për të konfirmuar ecurinë e shërbimeve përmes të dhënave në shifra dhe data. Mbi bazën e të dhënave në Raport do të lejohet edhe pagesa për ekezekutim të shërbimeve për muajin gjegjës.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit – Organi mbikëqyrës : do të emërohet me vendim të veçantë nga Zyrtari Kryesor Administrativ i Autoritetit Kontraktues, pas nënshkrimit të kontratës.  Do të jetë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrjen e cilësisë, sasisë dhe përshtatshmërisë së ekzekutimit të shërbimeve në terren, në pajtim me dispozitat e saktësuara si në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Ligjin

		për Komunikacionin dhe detyrat e përshkuara në vendimin mbi emërimin.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <b>N / A</b>
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <b>N / A</b>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë : sipas porosive të Menaxherit të Kontratës, por jo më gjatë se 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është: Kontraktuesi është përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve të kontraktuara në cilësi, sasi dhe përshtatshmëri me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.
Pagesa shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson kostoshtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është : 10 % e çmimit të përgjithshëm të kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Në pajtim me nenin 20 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në <b>Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike</b> , në pajtim me ligjin në Kosovë.





# ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

## Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 130187

Për Komuna Vushtrri

( Emri i "Autoritetit Kontraktues" )

Në emër të **Abdurrahman Fazilu B.I.**

( emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik )

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Lot-8 Transport i nxevesve ne relacionin nga Fashati Kollë dhe Bruzëk, lagjet Ilazi, Kolla, Muzaqi, Shaqiri, dhe Mehmeti ne SHFMU Emin Duraku ne Novolan dhe anëtarësit**  
Nr. prokurimit: VU644-24-7673-2-1-1 , Nr. brendshëm: VU644-24-059-211

### Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke ju referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **1,725.86€** zotohem të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **1,725.86€** siç është lartëcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 396 ditë kalendarike prej **02.09.2024** deri më **03.10.2025**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 02.09.2024

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.



# ELSIG

Gjithcka që duhet ta keni

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a., Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismajli"-nr,19,  
Tel: +383 (0) 38 221 112; Fax: +383 (0) 38 221 115, E-mail: office@kselsig.com



## POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS

Nr. Polices: **130187**

<b>Kontraktuesi</b>	
Emri	Abdurrahman Fazliu B.I.
Përfaqësuar nga	Abdurrahman Fazliu
Adresa	Kollë,
Nr i Biznesit	810693160
Telefoni	0444434413
<b>Përfituesi</b>	
Emri	Komuna Vushtrri
Adresa	Sheshi Hasna Prishtina
<b>Garantuesi</b>	
Emri	Elsig
Banka	NLB
Garantuesit	
<b>Mbulueshmëria e Polices</b>	
Shuma Siguar	1,725.86
Periudha Sigurimit	02.09.2024 - 03.10.2025
Primi	33.70
Tvsh	6.07
Primi Bruto	39.77
Data e lëshimit	02.09.2024 12:01
<b>Aktiviteti Ekonomik:</b> Lot-8 Transport i nxevesve ne relacionin nga Fashati Kollë dhe Bruznik, lagjet Ilazi, Kolla, Muzaqi, Shaqiri, dhe Mehmeti ne SHFMU Emin Duraku ne Novolan dhe anasjelltas	

### Lënda e Garancisë

Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:

- Mbështetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merre përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktori i cili është i garantuar me këtë police.
- Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
- Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit/Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesit/Garantuesit).
- Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.
- Për policia të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave - pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (të Siguruarit) di dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit ti ruaj të dhënat e mia personale / të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënkuptohet se unë i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit.  
My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions



Kompania e Sigurimeve Elsig  
Saranda Shkodra - 1703



Përfaqësuesi i të siguruarit  
Abdurrahman Fazliu